

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	KAFE SHQETO - Denoncimi i Ahmetajt për trafikun e armëve, Cara: Paratë e shqiptarëve po i vjedhin miqtë e Ramës, SPAK hesht...
ADRESA	https://www.syri.net/politike/915343/denoncimi-i-ahmetajt-per-trafikun-e-armeve-cara-par-ate-e-shqiptareve-po-i-vjedhin-miqte-e-rames-spak-hesht-hellip/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 06:51:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 06:19:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	78944d44c7ac00e01fd9eaadd9988b1017a376716ffe1c4526e21786d5943cd
TEKSTI	f2567963d597c0a5cf6e27eb67c5a7010e967f7ef08549b2a69983bfa99132c3
PAMJA	b9493a382f8a0448fd1bf6f9fea802e2d6726f4c6cee27db39ef02854d0644fe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3b8945158b68b657f08ebc232c33a94d9190e15052de6597b235fb399f2aed28
E MËPARSHMJA	cf518790e0e25e1f84fb514ee9bb04d5507d47de8825e691f4de734826829f64
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3b8945158b68b657f08ebc232c33a94d9190e15052de6597b235fb399f2aed28>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Për ne](#)
- [Redaksia](#)
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)
- [Edicioni i Kosovës](#)
-
- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Op-Ed](#)
 - [Analizë](#)
 - [Blog](#)
- [PLUG](#)
-
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)

toggle menu

 [Irena Beqiraj](#) [Irena Beqiraj](#) [Në Shtetin e Ronit!](#)

 [Ilir Kalemaj](#) [Ilir Kalemaj](#) [Sezon i ri, probleme te vjetra](#)

-
-
-
-

Denoncimi i Ahmetajt për trafikun e armëve, Cara: Paratë e shqiptarëve po i vjedhin miqtë e Ramës, SPAK hesht...

ZMADHO TEKSTIN08:19, 09/09/2026



I ftuar në emisionin “Kafe Shqeto”, deputeti i Partisë Demokratike, Igli Cara u shpreh se Shqipëria, pas 14 viteve të qeverisjes së Edi Ramës, është përfshirë në një nivel të ri të kriminalitetit, tashmë edhe në trafikun ndërkombëtar të armëve.

Duke iu referuar përgjimeve të bëra publike në Syri Tv, Cara akuzoi qeverinë se paratë e shqiptarëve po përdoren në skema pa transparencë dhe pa garë, ndërsa lidhjet e përmendura në përgjime e kanë kthyer çështjen në një problem me përmasa ndërkombëtare.

Deputeti demokrat kritikoi edhe heshtjen e qeverisë dhe të SPAK-ut, duke theksuar se kanë kaluar rreth 36 orë nga publikimi i përgjimeve dhe nuk ka pasur asnjë reagim zyrtar.

Cara tha se Edi Rama ka kapur të gjitha pushtetet dhe se tashmë qeverisja është kthyer në një strukturë që funksionon në interes të një grupi të ngushtë.

Ai akuzoi qeverinë për transferimin e fondeve publike përmes kompanive shtetërore dhe private, ndërsa deklaroi se mungesa e transparencës dhe abuzimi me paratë publike po dëmtojnë pensionet, shëndetësinë, infrastrukturën dhe ekonominë.

Cara tha se shqiptarët po përballen me një shtet që po degradon dhe kjo po nxit veçanërisht të rinjtë të largohen nga vendi.

Pjesë nga intervista:

Kemi arritur në një pikë të asaj dite që tanimë pas 14 viteve të qeverisjes së Ramës, përveç elementëve të caktuar kombëtarë të krimit, tani e kemi ndërkombëtarizuar. Tanimë e kemi edhe me Ukrainën, kemi edhe shtetas përfaqësues të Izraelit dhe me radhë. Tanimë Shqipërinë e kemi ngritur akoma më lart, për sa i përket trafikimit të armëve. Pra, jemi përmendur për shumë gjëra, por tanimë e kemi ngritur stekën, e kemi në nivel qeveritar. Tanimë jemi bërë fiks shteti i Ronit dhe për më tepër, duhet thënë që kur sheh aty se si paratë e shqiptarëve i vendos Roni, se si do të kalojnë, mënyra fenomenale ishin disa shprehje. Për shembull kur tha: "Dëgjo", tha, "që mos të dukemi", tha, "keq", tha, "ta bëjmë", tha, "një kompani amerikane". Nuk e di a e kemi dëgjuar.

"I rregullojmë këto letra". Sidomos në Shqipëri kemi parë çudira dhe çudirat vazhdojnë. Dhe unë kam përshtypjen që do të dëgjojmë akoma më tepër në muajt në vazhdim. Pra, ky është bërë një vend i cili më vonë unë jam i sigurt që do të shkruhen libra dhe do të bëhen dhe filma. Kudo në botë askush nuk e imagjinonte kurrë. As unë në 2013-ën kur kaluam në opozitë dhe erdhi Rama në pushtet, pavarësisht se e mendonim situatën të keqe, por kurrë nuk do ta mendonim situatën të degraduar në këtë farë feje. Kemi tani një shtet i cili paratë e shqiptarëve i merr dhe në mënyra të ndryshme, është gjetur një mënyrë që paratë e shqiptarëve Rama t'i ndajë me miqtë e tij kudo në botë dhe aq më tepër me trafikantë. Mos harrojmë që ne jemi një vend anëtar i NATO-s, dhe një vend anëtar i NATO-s të merret me trafik armësh dhe të marrë para shqiptarësh dhe t'i kalojë në kanale të fshehta pikërisht tek miqtë e Ramës, kjo është e papranueshme.

Dhe aq më tepër janë para të cilat janë shumë, janë miliona e miliona euro, të cilat as nuk tenderohen, as nuk ka garë, as transparencë, as llogaridhënie. Fare fare, sikur të ishin lekët e Ramës, t'i marrë nga kasetat e tij personale dhe t'ia japë kujtdo. Pra kjo është Shqipëria sot. Dhe në këtë rast dua t'ju falënderoj juve si televizion për të gjitha, pse jo, një falënderim, pavarësisht se dikush do të thotë si po e falënderon, pra edhe për zotin Ahmetaj e kam, sepse me thënë të drejtën, pavarësisht se i pamë gjërat ndryshe, kemi pasur debate, mbaj mend edhe nëpër komisione kemi debatuar ashpër me të, por ama një shërbim këtij vendi ia ka bërë me këto fakte, me këto përgjime. Tanimë nuk kemi më çfarë flasim, kjo është e vërteta. Tani, dhe më e dhimbshmeja është që kanë kaluar kaq orë. Kanë kaluar rreth 36 orë afërsisht.

Nuk kemi asnjë reagim, as nga qeveria Rama, zero. Nuk kemi asnjë reagim as nga SPAK-u. Dhe tani, për t'u kthyer pak në retrospektivë, meqë jeni media, ju kujtohet që në vitin 2014, në qoftë se e mbani mend mirë, ka pasur një rast të tillë në televizionin Klan. Dhe menjëherë sapo një gazetar aty, më kujtohet Hoxha në qoftë se e mbaj mend mirë, nxori një foto dhe nxori një fakt, u rrethua Klani, erdhi prokuroria, mori provat dhe vazhdoi hetimin. E njëjta gjë ka ndodhur dhe me një televizion që hapur është pro Ramës, kur u tha një fakt për sa i përket lobimeve të Partisë Demokratike dhe menjëherë u shkuan dhe u morën provat për të vërtetuar dhe u hap procedim penal kryesisht. Nuk e di a ju kujtohen të dyja rastet.

Çuditërisht për një rast të tillë, me audio-përgjime, me fakte kaq të dukshme, SPAK-u nuk lëviz fare. Sikur s'ka ndodhur asgjë. Dhe po të shobësh, përveç jush dhe disa mediave të tjera që dhe ato i falënderoj, 70-80% e mediave as e kalojnë, e thonë si një lajm të rëndomtë. Ku ky është kulmi, sepse kjo tregon të vërtetën se çfarë po ndodh me këtë vend. Dhe kjo nuk është më Parti Socialiste, tani nuk kemi më Parti Socialiste, e kemi thënë me kohë. Tani kemi një bandë në qeverisje, se duhet hequr termi Parti Socialiste, nuk ka Parti Socialiste. Kemi një bandë e cila kryesohet nga kryetari i saj që është Edi Rama.

Dhe kjo është e vërteta dhe për këtë shqiptarët duhet të reagojnë. Tani, në këtë moment, të gjithë njerëzit... Tani Rama përveç asaj që e kemi diskutuar nga studioja juaj, Rama kontrollon çdo pushtet, kjo është e padiskutueshme, sepse e dimë që ka qeverinë, e dimë që ka parlamentin, drejtësinë një pjesë të mirë të saj e ka, nuk po them 100% por një pjesë të mirë të saj e ka, e ka pushtetin lokal sepse dhe lejet e ndërtimit, çdo gjë i jep vetë, pra është dhe kryebashkiak. E ka dhe bandat shqiptare, po tani po merr dhe rolin e kryetarit të bandave të trafikut ndërkombëtar. Pra jemi akoma një hap më lart.

Dhe është i gjithë ky modeli, dhe çfarë bëjnë? Kanë filluar, krijojnë kompani shtetërore, ku paratë fillimisht kalojnë te kompanitë shtetërore, pastaj bëhet një kontratë, ku 80% ja kalon aksionet një kompanie fantazmë e cila nuk hulumton asnjë qindarkë, pra punon me paratë e shqiptarëve dhe pastaj hapen dhe disa filiale të tjera apo disa kompani të tjera të cilat përsëri marrin para shqiptare. Hemorragji pafund financiare nga buxheti i shtetit dhe pastaj është normale që ne nuk kemi para as për të rritur pensionet, nuk kemi para për të pasur spitale më të mira, rrugët ju e dini mirë në ç'gjendje janë, kuptohet që prodhimi ka rënë në pikiatë, nuk kemi më as prodhim bujqësor, dhe kjo është Shqipëria sot. Një Shqipëri e cila po shkon keq e më keq dhe shqiptarët duan të ikën nga ky vend një orë e më parë. Dhe sondazhet janë dëshpëruese, ku një pjesë e mirë e të rinjve duan të ikën dhe mos kthehen më.

© SYRI.net

Lexo edhe:

-  Pas më shumë se një muaji pritje, sot zhvillohet seanca për konstituimin e Kuvendit të Kosovës
-  "Gjueti shtrigash" ndaj mjekëve, paratë vidhen nga Rama', Eskiu: Shëndetësia është lënë në mëshirë të fatit
-  Për çfarë i shpenzojnë paratë shqiptarët dhe europianët: 29% për ushqime, gati trefishi i BE-së

Më të lexuarat

[Politikë](#)

Baçi publikon videon: Një tjetër vatër zjarri kërkon ndërhyrje urgjente në Frakull, para se të jetë shumë vonë

[Politikë](#)

Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit

[Politikë](#)

A ka funksionuar liria edhe për ju?/ Berisha: Në mënyrën më të fuqishme

[Politikë](#)

Roni pasqyra Rama

[Politikë](#)

Berisha në SHBA, Spahia: Një zhvillim historik jo vetëm për PD por për krejt Shqipërinë – Rama drejtues i një rrjeti kriminal...

[Politikë](#)

Paloka: SPAK-u është kthyer në zjarrfikës të gjitha aferave korruptive të Edi Ramës

[Politikë](#)

KAYO, afëra e armëve që çon te Rama, Balluku dhe Ron Yefet/ Balliu: Ku është drejtësia?

[Politikë](#)

Gjin Gjoni ngre alarmin: Zjarri po u afrohet banesave, kishave dhe varrezave në Ungrej! Të ndërhyhet

[Politikë](#)

Trafik armësh, korrupsion dhe shantazh/ Spahia: Kreu i organizatës kriminale, Edi Rama të japë dorëheqje të menjëhershme!

[Politikë](#)

Berisha në SHBA/ Ja salla ku do të mbahet takimi i liderit të opozitës me shqiptarët në New Jersey

TË NGJASHME

[Politikë](#)

[Noka: Policia ‘flakë’ sot, ndërhyri më shpejt ndaj protestuesve se ndaj zjarreve](#)

Politikë

[Berisha: Dënoj terrorin policor e mediatik ndaj protestuesve paqësorë, Rama të japë dorëheqjen e menjëhershme](#)

Politikë

[Banorët e Njësisë Administrative Baz kundër shkrirjes së Bashkisë Klos](#)

Politikë

[VIDEO/ 40 ditë protestë në Divjakë kundër reformës territoriale të Ramës që shkrin bashkinë](#)

Politikë

[Përmbytjet, mungesa e investimeve, deputeti Arian Ndoja mbështet protestën e banorëve të Kënetës](#)

Politikë

[Përgjimet e Ahmetajt 'çelin' sesionin e ri parlamentar! Kuvendi në shtetrrëthim nga frika e protestuesve](#)

Politikë

[Testi PISA 2025 : Për të mbuluar pluhurin që u ka zënë fytyrën janë gati t'i bëjnë të gjitha](#)

- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Arkiva](#)

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

[Denonco](#)

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!